



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.
____.____.2024

Tiranë, më

VENDIM

Nr. 25, datë 24.01.2024

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është

konstatuar se subjekti e identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Rastet e vëzhguara tregojnë se ai ka shqyrtuar çështje gjyqësore që lidhen me të drejtën tatimore (shih dokumentet 1 dhe 3), me mënyrat e fitimit të pronësisë dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme (shih dokumentin 2 dhe dosjen 5), me proceduralen e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, kur i padituri është organ publik (shih dosjet 1 dhe 2), me procedurat e kundërshtimit të akteve administrative të dënimit me gjore për kundravajtje administrative (shih dosjen 3) dhe me procedurën e ekzekutimit të detyrueshem të titujve ekzekutive (shih dosjen 4).

Ai është i qartë së vendimi gjyqësor në gjykatat administrative, krahas elementeve të përcaktuar në nenin 310 të K.Pr.Civile, duhet të përmbajë edhe elementet shtesë të kërkuar nga neni 41 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Megjithatë në një rast është konstatuar se nuk e ka zbatuar këtë dispozitë (shih dokumentin 1).

Ka njohuri për parimet themelore të procesit gjyqësor administrativ dhe gjatë gjykimit i përdor ato, por në arsyetimin e vendimeve nuk gjenden raste ku ai t’i referohet parimeve në zbatimin e ligjit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në drejtim të procedurës së gjykimit, subjekti ka njohuri të përgjithshme, por tek detajet ka vështirësi.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari përpara përcaktimit të fakteve të çështjes, përgjithësiht pasqyron proceduralen e ndjekur nga gjykata dhe vendimet e marra në funksion të zbatimit të saj. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore¹, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) vlerësimi i gjykatës lidhur me legjitimitimin e palëve në proces² (ii) vendimmarrja e ndërmjetme lidhur me masën e sigurimit të padisë³.

¹ Thuajse në të gjitha vendimet, përveç se në vendimet nr.276, datë 25.05.2015, vendimi nr.376 datë 09.06.2014, vendimin nr.257, datë 18.05.2015 dhe në vendimin nr.591 datë 16.11.2015, ku mungon marrja në shqyrtim i këtyre rrethanave procedurale.

²Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

³ Vendimi nr. 591, datë 16.11.2015, Vendimi nr. 257 datë 18.05.2015; Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, i cili në fakt nuk është sigurim padie, por pezullim i veprimeve përmbartimore sipas nenit 609 dhe 610 të KPRC.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural në ato raste kur janë marrë në analizë këto rrethana, gjyqtari parashtron faktet e çështjes, duke i identifikuar ato në pjesën më të madhe të vendimeve burim vlerësimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e çështjes”⁴. Përgjithësisht, tek kjo pjesë, gjyqtari paraqet shkurtimisht edhe njëherë padinë me të cilën pala i është drejtuar gjykatës dhe më pas vijon me një përshkrim të shkurtër të rrethanave të faktit, siç kanë rezultuar të provuara në gjykim, duke integruar në disa raste me provat shkresore mbi të cilat mbështeten faktet e referuara. Në disa raste, rrethanat e faktit (por edhe provat) nuk pasqyrohen të plota në këtë nënpjesë, duke mos dhënë një panoramë të qartë të rrethanave të çështjes, por në disa raste këto rrethana dalin gjatë analizës së çështjes tek pjesa e analizës dhe argumentit të vendimarrjes dhe në disa raste nuk dalin të qarta⁵. Më pas në nënpjesën “Pretendimet e palëve” parashtrihen më vete, në mënyrë të përmbledhur pretendimet e secilës palë, si dhe argumentat e provat ku i mbështesin pretendimet e tyre. Në vendimet e përgjiedhura nga gjyqtari nënndarja “Rrethanat e çështjes” nuk është dhe rrethanat përshkruhen direkt pas “Vëren”, pas përshkrimit të rrethanave procedurale, rrethana të cilat paraqiten në mënyrë tepër të përmbledhur, duke mos u sqaruar të gjitha rrethanat e provuara gjatë gjykimit.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Nga identifikimi dhe përshkrimi i fakteve të çështjes, gjyqtari përgjithësisht përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, konkretisht nëse jemi përpara një kundërshtimit të një akti administrativ, marrëdhënie pune apo pavlefshmëri titulli ekzekutiv.

Gjyqtari identifikon dhe përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, pas paraqitjes së rrethanave procedurale, analizës së faktit dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, duke analizuar objektin dhe shkakun e padisë, si dhe përmes gjithë analizës së kuadrit ligjor mbi të cilin themelohet kërkimi. Gjithashtu evidentohet se përcaktimi i natyrës së çështjes bëhet duke evidentuar qartë aktin, veprimin, mosveprimin, administrativ, si pasojë e të cilit pala paditëse ka ngritur pretendimet objekt padie duke kërkuar sipas rastit, detyrimin për dëmshpërblim, pavlefshmërinë absolute ose relative të aktit, shfuqizimin e aktit administrativ dhe detyrimin e organit administrativ për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ. Kjo analizë i shërben prezantimit të qartë të natyrës së konfliktit, si dhe orienton një vijim arsyetimi ligjor.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështje, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari përgjithësisht identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar përgjithësisht kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore

⁴ Thuajse në të gjitha vendimet.

⁵ Si psh Vendimi nr. 549, datë 15.09.2014, vendimi nr. 683, datë 06.11.2014, vendimin nr.613, datë 24.11.2015, vendimin nr.44, datë 25.01.2016, vendimin nr.376, datë 09.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Por në disa vendime, konstatohet se gjyqtari nuk ka cituar dispozita ligjore material apo përmbajtjen e tyre, të cilat në fakt referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, referuar përmbajtjes së vendimit, konkretisht, rezulton se në vendimin nr.44, datë 25.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, gjyqtari ka cituar dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.02.1999, si dhe të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010, duke cituar më pas vetëm nenin 609 të K.PRC, por jo përmbajtjen e tij dhe nuk ka cituar nenin 610 të KPRC, megjithëse ka padia është mbështetur tek këto dy dispozita, për të cilën gjykata është shprehur për pranimin e padisë, duke konstatuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe anulimin e veprimeve përbarimore. Në vendimin nr.284, datë 27.05.2015, gjyqtari nuk ka cituar ndonjë dispozitë që gjen zbatim në rastin konkret, megjithëse nga pala paditëse e ka mbështetur padinë e saj tek disa dispozita të Kodit Civil, duke pretenduar përmbushjen e një detyrimi kontraktor të lindur nga kontrata e lidhur midis palëve ndërgjyqëse. Në mbështetje të vendimarrjes së saj gjykata në këtë rast ka cituar ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurorimin publik” dhe VKM nr.3, datë 15.02.2001, po pa cituar dispozitat përkatëse që gjejnë zbatim në rastin konkret. Ndërsa në vendimin nr.683, datë 06.11.2014, gjyqtari ka cituar dispozitat e një ligji, pa identifikuar ligjin përkatës, numrin dhe titullin e tij, ligj që në fakt nuk është interpretuar dhe analizuar nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, dhe as ka cituar dispozitat e Kodit të Punës, përse kohë që objekti i padisë është shfuqizimi i urdhërit për largim nga puna dhe shpërblimet që rrjedhin nga marrëdhënie e punës.

Megjithatë, nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari identifikon, referon dhe citon dispozitat me karakter procedural dhe material, si më poshtë:

- nenet 7, 9, 11 dhe 15 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në lidhje me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësor të gjykatës⁶;
- neni 28 dhe 29 të ligjit nr.49, datë 03.05.2012 në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë⁷;
- neni 45/b i ligjit nr.49, datë 03.05.2012 në lidhje me paankueshmërinë e vendimeve të gjykatës administrative⁸;
- neni 23 I K.Pr.Administrative në lidhje me kompetencën e organit administrativ⁹;
- neni 176 i K.Pr.Civile në lidhje me legjitimitimin e palëve në proces¹⁰;
- neni 202 i K.Pr.Civile në lidhje me sigurimin e padisë¹¹;
- neni 106 i K.Pr.Civile në lidhje shpenzimet gjyqësore¹²;

⁶ Thuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi, përveç vendimeve nr.276, datë 25.05.2015, vendimi nr.376 datë 09.06.2014, vendimin nr.257, datë 18.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

⁷ Vendimi nr. 591, datë 16.11.2015; vendimi nr. 257, datë 18.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

⁸ vendimi nr. 158, datë 09.03.2016; Vendimi nr. 613, datë 24.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

⁹ Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

¹⁰ vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

¹¹ vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

- neni 163 i K.Civil në lidhje me mënyrat e fitimit të pronësisë¹³
- neni 609 i K.Pr.Civile në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv¹⁴;
- neni 56 e në vijim i K.Pr. Administrative në lidhje me vendimmarrjen në kundërshtim më ligjin të institucionit publik në nxjerrjen e aktit administrative¹⁵;
- neni 60 i K.Pr.Administrative në lidhje me mënyrat e njoftimit të aktit administrative dhe neni 140 i K.Pr.Administrative në lidhje me afatin e njoftimit dhe marrjes dijeni të aktit administrativ¹⁶;
- nenin 108 i K.Pr.Administrative në lidhje me arsyetimin e aktit administrativ¹⁷.
- nenin 116 të K.Pr.Administrative mbi shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ¹⁸;
- nenet 180-182 të K. Penal në lidhje me veprat penale të fshehjes së të ardhurave dhe mospagimit të taksave dhe tatimeve, por nuk është cituar përmbajtja e këtyre dispozitave¹⁹;
- neni 192, 193 të K. Civil dhe në lidhje me regjistrimin e pasurive²⁰;
- neni 202 e vijues i K.Pr. Penale në lidhje me kushtet për kryerjen e kontrolleve dhe sekuestrimin e sendeve, por nuk është cituar përmbajtja e kësaj dispozite²¹;
- nenet 140, 141, 143, 144, 145, 146, 153, 155 të Kodit të Punës, në funksion të vlerësimit të afatit të zgjidhjes së kontratës së punës, procedurën, shkaqet e zgjidhjes së kontratës, pasojat që vijnë prej zgjidhjes së marrëdhënies së punës²².

Gjyqtari identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- nenet, 13, 14, 16, 17, 23 dhe 59 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”²³;
- nenin 14 dhe 22 të ligjit 7512/1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit”; nenet 3 dhe 4 të ligjit 7980/1995 “Për shitblerjen e trojeve”, nenin 45 të ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e

¹² Thuajse në të gjitha vendimet burim vlerësimi.

¹³ vendimi nr.130, datë 17.03.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

¹⁴ vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

¹⁵ vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër. Në fakt neni 56 e vijues e K.Pr.A ka lidhje me afatet dhe llogaritjen e tyre

¹⁶ vendimi nr. 44, datë 25.01.2016; vendimi nr.130, datë 17.03.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

¹⁷ Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

¹⁸ Vendimi nr. 376, datë 09.06.2014; vendimi nr.130, datë 17.03.2014; Vendimi nr. 7, datë 13.01.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

¹⁹ vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

²⁰ Vendimi nr. 376, datë 09.06.2014; Vendimi nr.387, datë 10.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

²¹ vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

²²Vendimin nr. 730, datë 01.12.2014; Vendimi nr. 549, datë 15.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

²³ Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016; Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

- pasurive të paluajjtshme”²⁴ dhe pikat 1 dhe 4 të VKM nr. 562, datë 09.10.1995 “Për shitjen e truallit të ndërmarreve që privatizohen në lidhje me kalimin e pronësisë dhe regjistrimin e pasurive të paluajjtshme private dhe shtetërore”²⁵;
- nenet 20, 36, 37, 38, 39, 40 dhe 41, por pa identifikuar ligjin përkatës, numrin dhe titullin e tij. Nga pjesa arsyetuese e vendimit, konstatohet se bëhet fjalë për ligjin nr.10032/2008, por edhe në këtë rast nuk është cituar titulli i tij. “Këto dispozita janë cituar në lidhje me emërimin dhe lirimimin e punonjësve nga detyra, masat disiplinore, autoritetin e dhënies së masave disiplinore, ankimin dhe komisionin e ankimit ndaj masave disiplinore”²⁶;
 - nenet 15 dhe 20 të ligjit 9636/2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar në lidhje me ndalimin e pirjes së duhanit në ambiente të caktuara dhe masat që merren për shkeljen e këtyre dispozitave si dhe nenin 46 të ligjit 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”²⁷ në lidhje me procesverbalin e inspektimit²⁸;
 - nenin 72 i ligjit 8378/1998 “Kodi rrugor”²⁹ dhe VKM nr. 763, datë 06.12.2005 “Për një ndryshim në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave” në lidhje me ndalimin e përdorimit të perdeve të errëta në autovetura³⁰;
 - nenet 5/gj, 70/3, 106, 108 dhe 109 të ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”³¹, i ndryshuar, nenet 10/1, 19 të ligjit 9632/2006 për “Sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 101119/2009 “Për planifikimin e territorit” në lidhje me detyrimet tatimore të bizneseve të vegjël³²;
 - udhëzimi nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar dhe ligjit nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik”, në lidhje me personat që mund të kryejnë mbikqyrjen e punimeve në objektet që ndërtohen me financim publik³³;
 - nenet 5, 9, 16 dhe 32 të ligjit 8652/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”³⁴, nenet 20, 21, 22 dhe 24 të ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe nenet 2, 3 dhe 4 të ligjit 10116/2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76% të aksioneve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (OSSH)” në lidhje me zbatimin e taksave vendore³⁵;
 - nenet 15, 25 i ligjit 8450/1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” në lidhje me stacionet e karburanteve dhe nenet 20, 21,

²⁴ Vendimi nr. 376, datë 09.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

²⁵ Vendimi nr.387, datë 10.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

²⁶ Vendimi nr. 683, datë 06.11.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

²⁷ Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016; Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

²⁸ vendimi nr. 158, datë 09.03.2016; i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

²⁹ Edhe në këtë rast gjyqtari citon numrin e ligjit por jo titullin e tij.

³⁰ Vendimi nr. 613, datë 24.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

³¹ Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015; vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

³² vendimi nr. 257, datë 18.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

³³ vendimi nr. 284, datë 27.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

³⁴ Vendimi nr. 7, datë 13.01.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

³⁵ vendimi nr.130, datë 17.03.2014; Vendimi nr. 7, datë 13.01.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

- 22 të ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore” në lidhje me taksat për zënien e hapësirave publike³⁶;
- nenin 2 dhe nenin 8 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe Udhëzmit nr. 2, datë 02.08.1991 dhe nenit 5 të VKM-së nr. 230, datë 22.07.1991 në lidhje me detyrat e komisionit të fshatit në dorëzimin e tokave bujqësore fshatarëve; nenet 24 të ligjit nr. 7843/1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”³⁷;
 - nenet 13, 30, 31, 32, 33, 34 të ligjit 9634/2006 “Për inspektimin e punës dhe inspektoratin shtetëror të punës” në lidhje me ushtrimin e kontroleve në ambientet e punës, zbulimin e shkeljeve, sanksionet, gjobvënja dhe ankimi ndaj vendimit për gjobë dhe pikën 4 dhe 5 të VKM nr. 753, datë 08.09.2010 “Për bashkëpunimin e inspektoriatit shtetëror të punës me institucionet në varësi të Ministrisë së financave”³⁸
 - neni 11 dhe 29 i ligjit nr. 10129/2010, në lidhje me fitimin e tatueshëm, por nuk identifikon titullin e ligjit. Ky numër në fakt i korespondon ligjit “Për gjendjen civile”, dispozita të cilat nuk kanë lidhje me përmbajtjen e dispozitave të cituara nga gjyqtari në vendim. Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 i Ministrisë së Financave dhe VKM nr. 400, datë 22.04.2009 “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të drejtorisë së hetimit tatimor”³⁹;

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 155 të Kushtetutës në lidhje me fuqinë prapavepruese të ligjit. Kjo fuqi nuk mund t’i jepet ligjeve për taksat dhe tatimet⁴⁰;
- Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me të drejtën për tu ankuar ndaj aktit administrativ, i cili përbën element të procesit të rregullt ligjor⁴¹.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

³⁶ Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

³⁷ Vendimi nr. 376, datë 09.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

³⁸ Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

³⁹ vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁴⁰ vendimi nr.130, datë 17.03.2014; vendimi nr. 257, datë 18.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁴¹ Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të kuptueshme të fakteve të çështjes, proces të cilin gjyqtari e arrin duke u bazuar shumë në pretendimet të palëve mbi rrethanat e faktit. Rezulton se gjyqtari jo gjithmonë përshkruan dhe analizon në mënyrë të qartë, koncize rrethanat dhe faktet e çështjes, si ato me natyrë procedurale dhe material, duke i integruar ato edhe me provat e marra në shqyrtim. Nga përmbajtja e vendimit kuptohet se përgjithësisht provat përshkruhen sipas përshkrimit dhe analizës që i ka bërë secila palë fakteve të çështjes në mbështetje të pretendimeve të tyre, duke mos dhënë kështu gjithmonë një panoramë të qartë të fakteve që kanë rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor. Gjithashtu, rezultoi se gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose material që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj. Por jo gjithmonë konstatohet kujdes i gjyqtarit në identifikimin, citimin dhe më pas analizimin e dispozitave që citon në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, pasi janë konstatuar mosidentifikim i qartë i ligjit, titullit apo numrit, i cili në një rast ka pasur mospërputhje, gjë që vështirëson kuptimin dhe qartësinë e vendimit, apo citimi i dispozitave të cilat nuk janë analizuar, apo citimi i ligjit në tërësi dhe jo i përmbajtjes së dispozitës përkatëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Mbi mesatare”, dhe pikëzohet me 20 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t’i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve konkludohet se: *“Ndonëse subjekti e ndan pjesën arsyetuese në rubrika të veçanta, ku një prej tyre tregon ligjin e zbatueshëm, kjo ndarje nuk është gjithnjë e qartë. Në një rast, është konstatuar se citohet përmbajtja e dispozitave ligjore, por pa treguar se kujt ligji i përkasin (shihni dosjen 3). Në ndonjë rast, analiza ligjore e vendimit bazohet në dispozita ligjore të tjera, përtej atyre që citohen tek pjesa, ligji i zbatueshëm (shihni dosjet 4 dhe 5). Në një rast tjetër, tek ndarja e ligjit të zbatueshëm, paraqiten nenet 68 – 69, të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por nuk tregohet se kujt ligji i përkasin këto dispozita. Në këtë pjesë, vendimi krijon paqartësi sepse të jep idenë që këto dispozita i përkasin ligjit nr. 10433/2011 (shihni dokumentin 3). Gjyqtari {...} përdor edhe shprehje përgjithësuese në vendim, të cilat në ndonjë rast e bëjnë të paqartë pjesën arsyetuese (shih dosjen 2, ku në fjalinë e fundit, të hartuar me gjuhë përgjithësuese, ai shprehet se padia duhet të pranohet tërësisht, kur në fakt ka disponuar për pranim të pjesshëm të padisë).*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, jo gjithmonë bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, për të ardhur më pas si rrjedhojë logjike konkluzioni i arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore në shumicën e rastëve citohen, por ato nuk shoqërohen me interpretimin e tyre para aplikimit mbi faktet e çështjes dhe më pas me aplikimin mbi faktet e çështjes⁴². Në disa raste, normat të cilat interpretohet apo përdoren nga gjyqtari për të mbështetur konkluzionet e tij, nuk janë normat e cituara në pjesën ligj i zbatueshëm, pra të cituara si ligj i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes⁴³. Analiza ligjore, në disa raste, është tepër minimale, duke u shprehur vetëm në një fjali. Në ato raste kur konstatohet interpretimi i dispozitave materiale jo gjithmonë bëhet sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së

⁴² Shih vendimin nr.387, datë 10.06.2014, vendimi nr.376, datë 09.06.2014, vendimi nr.6683, datë 06.11.2014, vendimi nr.284, datë 27.05.2015, vendimi nr.613, datë 24.11.2015, nr.44, datë 25.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

⁴³ Shih vendimin nr.158, datë 09.03.2016, vendimin nr.591 datë 16.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

mosmarrëveshjes. Duhet theksuar se gjyqtari më shumë bën një analizë të fakteve dhe rrethanave të çështjes, sesa një analizë të normës juridike dhe se si norma juridike gjen zbatim mbi faktet e çështjes⁴⁴.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet vetëm në pak raste në aspektin teorik të saj, interpretim i cili paraqitet tepër i përmbledhur në disa raste, duke përdorur vetëm një fjali, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në fakt, në vendimet burim vlerësimi konstatohet se analiza juridike përqendrohet vetëm në analizë të fakteve të çështjes, për të konkluduar nëse janë kryer apo marrë ose jo në përputhje me ligjin veprimet apo vendimet e organeve publike. Konstatohet se përdoret kryesisht interpretimi abstrakt i ligjit para aplikimit mbi faktet e çështjes tek 2 vendimet me objekt marrëdhënie pune. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari interpreton:

- Nenin 140 të K.Pr.Administrative në lidhje me afatin për njoftimin e aktit, gjyqtari relacion se fryma e nenit është që t'i krijon të gjitha mundësitë subjekteve përkatëse, që të marrin dijeni për përmbajtjen e akteve administrative nga të cilat preken dhe brenda afatit të realizojnë të drejtën e ankimit⁴⁵;
- Trajton në mënyrë sipërfaqësore barrën e provës duke shprehur detyrimin e palës së paditur të provojë faktin e njoftimit të aktit administrativ në njërin nga mënyrat e e parashikuara në nenin 60 të K.Pr. Administrative apo nuk paraqiti prova për të provuar pronësinë e palës paditëse mbi asset, por pa cituar apo analizuar dispozitën përkatëse të ligjit të posaçëm nga buron ky detyrim, ligji nr.49/2012 apo nëse këto dispozita interferojnë me dispozitat e KPRC⁴⁶;
- nenin 3 të ligjit 7980/1995 “Për shitblerjen e trojeve” në lidhje me ndalimin e kalimit nga të trojeve të lira shtetërore në troje private⁴⁷;
- neni 70, 72 i ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me të drejtën për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor dhe neni 24 i ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave Vendore” në lidhje me vërtetimin e pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave; nenet, 10, 19 i ligjit 9632/2006 “Për sistemin e taksave Vendore” dhe Udhëzimin nr.4, datë 27.01.2003 në lidhje me kualifikimin e biznesit të vogël dhe të drejtën

⁴⁴ Psh Vendimi nr. 683, datë 06.11.2014; Vendimi nr. 613, datë 24.11.2015, etj, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër.

⁴⁵ Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016; Vendimi nr.130, datë 17.03.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁴⁶ vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër.

⁴⁷ Vendimi nr.130, datë 17.03.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

e Bashkisë për të vendosur taksa vetëm për subjektet e regjistruara si biznes i vogël në atë bashki⁴⁸;

- neni 81 i ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” në lidhje me njoftimin e kontrollit tatimor dhe mënyrën e kryerjes së tij⁴⁹;
- nenet 13/b dhe 32 të ligjit 9634/2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës” si dhe neni 45 I ligjit 10433/2011 “Për inspektimin në RSH” dhe nenet 13, 14, 16 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në lidhje me detyrat e inspektoriatit të punës dhe mënyrën e mbajtjes së procesverbalit⁵⁰;
- trajton konceptin e afatit të njoftimit dhe institutin e zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar, duke u ndalur në zgjidhjen pa shkaqe të arsyeshme dhe zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar, shpërblimin për shkak të vjetërsisë duke interpretuar nenet 140/2, 141, 143, 144, 145, 146, 153, 155 të K.Punës⁵¹. Po kështu, merr në analizë pasojat e zgjidhjes së kontratës së punës, nisur nga kërkimet e pales, duke referuar, në Vendimin Unifikues nr.31/2003 të Gjykatës së Lartë lidhur me të drejtën e rikthimit në punë si një e drejtë që nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndërsa e drejta për t’u dëmshpërblyer po 52.

Në disa nga vendimet janë interpretuar dispozita të akteve nënligjore që gjejnë zbatim. Konkretisht, gjyqtari:

- Udhëzimin nr.4, datë 27.01.2003 në lidhje me të drejtën e Bashkisë për të vendosur taksa vetëm për subjektet e regjistruara si biznes i vogël në atë bashki⁵³;

- Në lidhe me interpretimit të dispozitave procedurale të zbatueshme.

Në lidhje me dispozitat procedurale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes evidentohet se, gjyqtari në disa raste interpreton dispozitat procedurale si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh në rastin e pavleshmërisë së titullit ekzekutiv. Konkretisht:

- Interpreton në mënyrë tepër të përmbledhur padinë për kundërshtimin e titullit ekzekutiv sipas nenit 609 të K.Pr.Civile, duke cituar në mbështetje të argumentit vendimin dhe

⁴⁸ Vendimi nr. 257, datë 18.05.2015, Vendimi nr.130, datë 17.03.2014, Vendimi nr. 7, datë 13.01.2014, Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁴⁹ Vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁵⁰ Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁵¹ Vendimin nr. 730, datë 01.12.2014; Vendimi nr. 549, datë 15.09.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁵² Vendimi nr. 5810, datë 20.10.2014, Vendimi nr.509, datë 10.02.2016, Vendimi nr. 2909, datë 03.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

⁵³ Vendimi nr. 257, datë 18.05.2015, Vendimi nr.130, datë 17.03.2014, Vendimi nr. 7, datë 13.01.2014, Vendimi nr. 276, datë 25.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

konkluzionit lidhur me vleshmërinë e titullit ekzekutiv nr.16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese⁵⁴. Në këtë vendim megjithëse gjyqtari shprehet në vendim për anulimin e veprimeve përmbartimore nuk ka cituar dhe më pas interpretuar nenin 610 të KPRC, që referon tek padia e kundërshtimit të veprimeve përmbartimore, përsa kohë që ka vlerësuar se përmbartuesi nuk ka vepruar në përputhje me ligjin ;

Ajo që konstatohet thuajse në të gjitha dosjet dhe vendimet burim vlerësimi (përveç se në vendimin nr.376, datë 09.06.2014 ku është thirrur avokatura e shtetit), është se gjyqtari nuk ka thirrur dhe nuk ka interpretuar domozdoshmërinë ose jo të njoftimit të Avokaturës së shtetit sipas nenit 79/a të KPRC⁵⁵, në çështjet administrative burim vlerësimi, ku duket se ka interes publik. Mosnjoftimi i avokaturës së shtetit dhe mos njoftimi i akteve përbën shkelje procedurale e cila çon si pasojë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes në shkallë të parë për rigjykim.

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur në disa raste jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe, Gjykatës Kushtetuese*), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Vendimin nr. 16, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të drejtën e ngritjes së padisë, sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile duke parashikuar që kjo padi mund të ngrihet pa kufizim për pavlefshmëri absolute të akteve administrative⁵⁶;
- Vendimin Unifikues nr.31/2003 të Gjykatës së Lartë lidhur me të drejtën e rikthimit në punë si një e drejtë që nuk gëzon mbrojtje gjyqësore, ndërsa e drejta për t'u dëmshpërblyer po 57.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton gjyqtari zbaton *parimin e procesit të rregullt ligjor*, pasi referuar kontekstit të arsyetimit të vendimeve, rezulton të jenë zbatuar drejtpërdrejtë aspekte të tij në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, aksesin në gjykatë, kontradiktorialitetin, të drejtën e disponimit të padisë, fuqinë provuese të provave të administruara në gjykim, të parimit absolut të paditësit për të disponuar mbi padinë, në rastin e pranimit të kërkesës për ndryshimin apo shtimin e objektit të padisë, etj. Në vendimet burim vlerësimi ka analizë sipërfaqësore të *parimit procedural të barrës së provës*.

⁵⁴ Vendimi nr. 44, datë 25.1.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

⁵⁵ Neni 79/a i KPRC parashikon se:” *Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim.*”

⁵⁶ Vendimi nr. 44, datë 25.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

⁵⁷Vendimi nr. 5810, datë 20.10.2014, Vendimi nr.509, datë 10.02.2016, Vendimi nr. 2909, datë 03.06.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka përgjithësisht aftësi mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet procedurale të analizuar, ashtu edhe në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjeve objekt gjykimi. Gjyqtari, në disa vendime burim vlerësimi, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin abstrakt dhe konkret, në aplikimin mbi faktin konkret apo për të mbështetur konkluzionin e arritur, interpretim i cili konstatohet kryesisht tek marrëdhëniet e punës. Por në disa vendime mungon tërësisht interpretimit i ligjit të cituar apo referuar nga gjyqtari në vendim, duke u arritur direkt në konkluzione apo duke bërë në disa raste vetëm analizë logjike të rrethanave të çështjes, por jo analizë ligjore. Përgjithësisht gjyqtari nuk bën analizë abstrakte të normës ligjore dhe shpeshherë citon disa norma ligjore njëherësh dhe del në konkluzionë bazuar në këto dispozita, por pa i analizuar ato. Në disa nga çështjet burim vlerësimi, gjyqtari ka referuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese në mbështetje të argumenteve të tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mbi faktet e çështjes apo për të mbështetur konkluzionin e tij

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin "Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes", vlerësohet "Mesatare", dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B ARSYETIMI LIGJOR

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohej një liri e konsiderueshme veprimi, përse i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të

cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar⁵⁸.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Ndonëse subjekti e ndan pjesën arsyetuese në rubrika të veçanta, ku një prej tyre tregon ligjin e zbatueshëm, kjo ndarje nuk është gjithnjë e qartë. Në një rast, është konstatuar se citohet përmbajtja e dispozitave ligjore, por pa treguar se kujt ligji i përkasin (shihni dosjen 3). Në ndonjë rast, analiza ligjore e vendimit bazohet në dispozita ligjore të tjera, përtej atyre që citohen tek pjesa, ligji i zbatueshëm (shihni dosjet 4 dhe 5). Në një rast tjetër, tek ndarja e ligjit të zbatueshëm, paraqiten nenet 68 – 69, të ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por nuk tregohet se kujt ligji i përkasin këto dispozita. Në këtë pjesë, vendimi krijon paqartësi sepse të jep idenë që këto dispozita i përkasin ligjit nr. 10433/2011 (shihni dokumentin 3).*

Konstatohet se, subjekti përdor edhe shprehje përgjithësuese në vendim, të cilat në ndonjë rast e bëjnë të paqartë pjesën arsyetuese (shihni dosjen 2, ku në fjalinë e fundit, të hartuar me gjuhë përgjithësuese, subjekti shprehet se padia duhet të pranohet tërësisht, kur në fakt ka disponuar për pranim të pjesshëm të padisë)..”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se;

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore përfundimtare përgjithësisht është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, shumë rrallë evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa), duke u shoqëruar gjithmonë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes

⁵⁸ Vendimi i GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

përkatëse në gjuhën shqipe, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁵⁹ Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose rezulton i qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fytes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarit për përzgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke pasur në vëmendje respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit.

Në arsytimin e vendimeve përgjithësisht evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara përgjithësisht në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit gjithashtu.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në çdo paragraf të tij. Thuajse të gjitha vendimet janë organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj dhe me paragrafë, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, të cilët lidhen me njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike.

Vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme nuk evidentohet në të gjitha vendimet e analizuara duke mos pasur një nënndarjen me titull “Ligji i zbatueshëm”. Kjo nuk pengon në arsytimin ligjor, zbërthimin dhe analizën e dispozitave të cituara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë për lexuesin. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit të shprehur, përgjithësisht mundësojnë

⁵⁹P.sh : *ratio loci, de facto, de jure; etj.*

lexim të organizuar që ofron kalime logjike nga njëra pjesë e vendimi tek tjetra, në shërbim të argumentimit të çështjeve të ngritura prej tij për zgjidhjen, apo zgjidhjen tërësorë të çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga pikëpamja formale, subjekti i harton vendimet duke ndjekur strukturën e nenit 310, të Kodit të Procedurës Civile dhe, duke iu referuar edhe nenit 41, të ligjit nr. 49/2012, me përjashtim të një rasti (shihni dokumentin 1). Vendimet e tij janë të ndara në pjesën hyrëse, në pjesën përshkruese - arsyetuese dhe në dispozitivin. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në raportin e plotë të mbajtur nga Inspektorati i Lartë i KLD-së (raporti nr. 3790/3 prot., datë 14.12.2018, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. {...}), me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa, pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara referohen sipas radhës së paraqitur në pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”. 29 68.2.1 Ndonëse subjektit i ndan pjesën arsyetuese në rubrika të veçanta, ku një prej tyre tregon ligjin e zbatueshëm, kjo ndarje nuk është gjithnjë e qartë..”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë relativisht të qëndrueshme dhe të organizuar. Gjyqtari ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese arsyetuese në nënndarje, të identifikuara në disa raste me tituj apo nëntituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit/mbrojtësit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti dhe baza ligjore e mosmarrëveshjes administrative si dhe kërkimet përfundimtare të palëve të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Siç është theksuar më sipër, në asnjë rast nuk është njoftuar dhe nuk është shënuar më pas si pjesmarrës në gjykim Avokatura e shtetit, sipas nenit 79/a të KPRC, përveçse në një vendim gjyqësor. Gjithashtu, gjyqtari nuk ka argumentuar njoftimin apo mosnjoftimin e tij në gjykim, megjithëse ky detyrimin ligjor buron nga neni 79/a të KPrC⁶⁰.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, megjithëse jo gjithmonë e ndarë me tituj apo nëntituj, në të cilën në mënyrë të detajuar gjyqtari:

- (i) ndalet në paraqitjen e padisë nga pala paditëse, si dhe evidentimin e vendimmarrjeve të ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në disa raste vlerësimin e lidhur me juridiksionin dhe kompetencën për shqyrtimin e kërkesë padisë.
- (ii) *Faktit dhe rrethanat e provuara në gjykim.* Në këtë pjesë gjyqtari përgjithësisht përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes, në disa raste ashtu sikurse janë pretenduar nga palët ndërgjyqëse, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, duke ndjekur kryesisht një rend kronologjik në paraqitjen e faktit.
- (iii) *Pretendimet dhe prapësimet e palëve,* pjesë në të cilën gjyqtari parashtron në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e secilës palë së bashku me argumentet e tyre. Në disa raste këto pretendime nuk janë parashtruar në tërësi nga gjyqtari, sidomos ato që lidhen me interpretimin ligjor të fakteve të çështjes ku ata bazojnë pretendimet e tyre.
- (iv) *Kuadri ligjor dhe zgjidhja juridike e çështjes,* në të cilën gjyqtari fillimisht citon ligjin material e procedural që zbatohen në çështjen konkrete, duke i referuar dispozitat materiale administrative, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik, përgjithësisht merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin e tij jo në mënyrë abstrakte, por mbi faktet konkrete apo për të mbështetur konkluzionin e arritur nga gjykata për zgjidhjen e çështjes. Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, gjyqtari nuk ka ndjekur metodën IRAC,⁶¹ duke shtruar, menjëherë pas përshkrimit të analizës së

⁶⁰ Neni 79/a i KPRC parashikon se:” Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin në rastet e parashikuara me ligj. Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim.”

⁶¹IRAC - Issue, Rule, Application, Conclusion

fakteve procedurale dhe thelbësore të çështjes, por është shprehur që në fillim mbi bazueshmërinë ose jo në prova dhe në ligj të kërkesë padisë. Pjesa e arsyetimit ligjor nuk është gjithmonë shumë e qartë. Gjyqtari nuk i merr një e nga një në mënyrë të organizuar çështjet që kërkojnë zgjidhje dhe pretendimet e palëve pasi disa pretendime nuk janë marrë në shqyrtim, megjithëse ato kanë gjetur zgjidhje në vendimin e dhënë nga gjykata⁶².

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve përgjithësisht është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (*pranimin/rrëzimin apo mospranimin e kërkesë padisë*), si dhe disponimin mbi shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi disponohet për të drejtën e ankimit sipas afateve ligjore ose për cilësinë e vendimit si i paankimueshëm⁶³. Por në dy vendime, konstatohet se gjyqtari nuk ka disponuar për ligjërimin e masës së sigurimit të padisë të marrë gjatë gjykimit, sipas nenit 212 të KPRC⁶⁴, konkretisht tek vendimi nr.591 datë 16.11.2015 dhe vendimi me nr.44, datë 25.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë (megjithëse konstatohet se ajo është marrë gjatë fazës së ekzekutimit, marrja e të cilës ndalohet nga neni 203 i KPRC⁶⁵.)

Disponimi lidhur me shpenzimet gjyqësore është i qartë dhe i plotë, pasi në të gjitha vendimet bëhet pasqyrimi i shpenzimeve gjyqësore, dhe përcaktimi i saktë faktit se kujt palë i ngarkohen shpenzimet.

Siç u theksua më lartë, gjyqtari megjithëse nga pikpamja formale duket se ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, nga përmbajtja e tyre nuk konstatohet një gjë e tillë sa i përket përmbajtjes së vendimit, në lidhje me strukturimin e mendimit juridik apo analizës së vendimi, në ndarjen e vendimit në paragrafë të cilat duhet të vijnë në rrjedhë logjike midis tyre. Të gjitha vendimet janë të ndarë në paragrafë, të cilët gjyqtari i përdor rregullisht, por këto paragrafë, jo gjithmonë janë rënditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit⁶⁶. Në disa raste, gjyqtari citon dispozitat e ligjit të zbatueshëm, por në analizë ligjore merr

⁶² Shih vendimin nr.730, datë 01.12.2014, vendimin nr.376, datë 09.06.2014, vendimin nr.44, datë 25.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

⁶³ Si psh Vendimi nr. 613, datë 24.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë

⁶⁴ Neni 212 I KPRC, parashikon se:” Kur në vendimin përfundimtar padia pranohet, gjykata vendos edhe ligjërimin e sigurimit të padisë.

Kur si masë siguri të padisë është vendosur sekuestrimi, ajo kthehet në sekuestrim ekzekutiv, pasi vendimi përfundimtar të marrë formën e prerë.”

⁶⁵ Neni 203 i KPRC, paragrafi i dytë parashikon se:” Sigurimi i padisë nuk lejohet në rastet e padive që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, për të cilat zbatohet pjesa e katërt e këtij Kodi.”

⁶⁶ Si psh në Vendimi nr. 376, datë 09.06.2014, Vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë etj

në konsideratë dispozita të tjera. Sikurse është përmendur më sipër, në disa raste citon dispozitat e zbatueshme por nuk citon titullin e ligjit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, pasi megjithëse ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, por nuk konstatohet e njëjta aftësi e strukturimit të mendimit në aspektin e përmbajtjes së tij. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë përgjithësisht janë pjesë e rrethanave të faktit dhe jo të ndarë më vete, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet së në disa vendime, për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar. Por nuk konstatohet e njëjta qartësi në pjesën arsyetuese të vendimit, në lidhje me strukturimin e mendimit në paragrafë që duhet të vijnë në rrjedhë logjike midis tyre. Gjithashtu, edhe pjesa e fundit e vendimit (dispozitivi) nuk është i plotë në lidhje me disponimin e gjykatës për rastet kur gjatë gjykimit ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar kërkesën e palëve për sigurimin e padisë, pasi nuk ka disponuar për ligjërimin e masës sipas nenit 212 të KPRC.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 8 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.⁶⁷

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim*);

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, vlerësuesi nuk është shprehur lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel i mirë arsyetimi, por jo gjithnjë i detajuar, i plotë apo i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin administrativ, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale dhe materjale të çështjes. Rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga proces përshkrues të rrethanave dhe faktit, dhe jo atë analitik, pra se si ligj gjen zbatim në raport me rrethanat e faktit.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, të cilat siç është theksuar në Raport jo gjithmonë paraqiten në mënyrë të saktë, të plotë dhe konçize, zhvillohet në disa raste mbi bazën e një analize juridike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, duke bërë një analizë tërësore dhe të përmbledhur të provave të

⁶⁷ *Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.*

administruara, në funksion të përcaktimit të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Ndërsa në disa vendime burim vlerësimi, gjyqtari nuk bën një analizën të koncepteve ligjore përpara aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes, por vetëm analizon rrethanat konkrete të çështjes, në raport me njëra tjetrën por jo gjithmonë në raport me ligjin e zbatueshëm të referuar nga gjyqtari, duke dalë më pas në konkluzionet përkatëse mbi bazueshmërinë në ligj ose në prova të kërkimeve të palëve.

Në vendimet që kanë si lëndë marrëdhëniet e punës (dy vendime të tilla), gjyqtari i kushton rëndësi analizës me të zgjeruar të instituteve dhe koncepteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, si dhe analizën e këtyre instituteve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, apo se si zbatohen ato në një situatë të caktuar. Ndërsa në disa vendime, megjithëse gjyqtari analizon institute apo koncepte të caktuara, kjo analizë jo gjithmonë përdoret në funksion të rrethanave konkrete të çështjes, pra se si zbatohen këto koncepte në raport me rrethanat konkrete të çështjes. Gjithashtu, në disa vendime mungon tërësisht analiza e instituteve apo koncepteve të së drejtës, por gjyqtari pas identifikimit dhe citimit të ligjit të zbatueshëm del në konkluzionet përkatëse vetëm referuar analizës së fakteve konkrete të çështjes edhe pse palët kanë ngritur pretendime lidhur me analizimin e këtyre koncepteve, psh, me njoftimin e masave disiplinore të marra gjatë marrëdhënies së punës, nëse do të konsiderohet të marra nëq nuk i janë njoftuar punëmarrësit, apo nëse shkelja disiplinore është në një masë të tillë sa mund të çojë në aplikimin e masës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës⁶⁸, ekzistencën e marrëdhënies kontraktore, të mospërbushjes së detyrimit të lindura nga një marrëdhënie kontraktore, kryerjes së një shërbimi⁶⁹, apo të ekzistencës së titullit të pronësisë, koncepti i të drejtës së pronësisë të fituar më parë në kohë.

Pra konstatohet se gjyqtari nuk tregon të njëjtën shkallë kujdesi tek të gjitha vendimet gjyqësore, në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore dhe argumentit logjik, në raport me faktet e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak- pasojë, e cila në disa raste paraqitet tepër skematike dhe në disa raste argumenti mungon, duke konkluduar direkt në konkluzionet e gjyqtarit lidhur me provueshmërinë dhe bazueshmërinë në ligj e në prova të kërkimeve të paraqitura. Në shumicën e vendimeve burim vlerësimi, analiza e gjyqtarit përqëndrohet tek rrethanat dhe faktet e provuara, dhe jo tek analiza e koncepteve dhe si si këto koncepte gjejnë zbatim mbi rrethanat e çështjes, e cila gjithashtu është një pjesë shumë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi. Gjyqtari nuk duhet të jetë thjesht përshkrues i rrethanave apo i provave siç ka rezultuar nga shqyrtimi gjyqësor e aq më pak me përshkrimin e tyre sipas pretendimeve të palëve, por duhet të analizojë provat në raport me njëra tjetrën, duke gërshtuar arsytimin e tij në raport me ligjin që gjen zbatim. Përgjithësisht konstatohet rrjedha logjike në arsytimin e vendimit dhe cilësia analitike e vendimit është në një nivel mesatare, pasi nuk spikat analiza juridike e koncepteve dhe e dispozitave ligjore në raport me rrethanat konkrete të çështjes,

⁶⁸ Vendimi nr.683, datë 06.11.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjjirokostar.

⁶⁹ Vendimi nr.284, datë 27.05.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjjirokostar.

e cila lidhet drejtpërdrejte me konkluzionet e arritura. Kjo mënyrë e të shkruarit të vendimeve jo gjithmonë evidenton qartë faktet e çështjes, apo nëse faktet konkrete të çështjes janë të asaj natyre, kualiteti apo cilësia juridike siç kërkohen nga dispozita konkrete që gjën zbatim, dukë bërë më pas lidhjen e drejtpërdrejtë me konkluzionet e arritura.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve.

Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat janë integruar ndonjëherë në pjesën “rrethanat e faktit” ashtu edhe në pjesën e “vlerësimit të gjykatës”, analizë e cila paraqiten në mënyrë të përmbledhur. Por jo gjithmonë gjyqtari identifikon qartë dhe në mënyrë të plotë pretendimet e palëve, duke i paraqitur ato të ndara, por ata dalin si rezultat i analizës juridike. Në çështjet më komplekse, gjyqtari është kujdesur të pasqyrojë dhe marrë në analizë pretendimet e palëve ndërgjyqëse (duke krijuar edhe paragrafë me fjali hyrëse në lidhje me këo pretendime), si në raport me arsyetimin e koncepteve ligjore dhe zërthimin e këtyre koncepteve në raport me rrethanat e provuara dhe provat përkatëse ku palët bazojnë pretendimet e tyre. Por edhe në këtë drejtim nuk konstatohet i njëjti kujdes i gjyqtarit, sidomos në analizën e pretendimeve të palëve në raport me ligjin, duke i integruar me faktet e çështjes. Kështu në vendimin nr. 44, datë 25.01.2016, mungon analiza e të gjitha kërkimeve të palës paditëse të pasqyruar në objektin e kërkesë padisë, të cilat janë pranuar në tërësi nga gjykata. Ndërsa në vendimet nr.683, datë 06.11.2014 dhe nr.284, datë 27.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokostar, gjyqtari nuk i ka dhënë një përgjigje të argumentuar për kërkimet e parashtruar në padi lidhur me zbatimin e ligjit në raport edhe me provat përkatëse. Gjithashtu, në një vendim⁷⁰, njëra nga dy palët e paditura pretendon se nuk duhet të ishte e paditur dhe ky ishte i vetmi pretendim i kësaj pale, për të cilën gjykata nuk ka dhënë një përgjigje të argumentuar, megjithëse në fund ka vendosur detyrimin vetëm për njërën prej palëve.

Pra, pretendimet e palëve jo gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsyetimit të vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësuar në tërësinë e tyre dhe në raport me natyrën çështjes, rezulton se gjyqtari ka aftësi mesatare në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Në disa vendime burim vlerësimi, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe mbështetet në pak raste në qëndrimet e praktikës gjyqësore, megjithëse nuk spikat interpretimi individual i ligjit dhe as argumentimi logjik. Duke i vlerësuar vendimet burim vlerësimi në tërësinë e tyre, nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizë dhe argumentit logjik, pasi në një pjesë të vendimeve mungon komponenti analizës juridike të ligjit të zbatueshëm dhe se si ky ligj gjen zbatim mbi faktet konkrete. Gjithsesi gjyqtari bën më shumë një analizë të fakteve sesa një analizë të ligjit mbi faktet. Gjithashtu edhe pse konstatohet se disa vendime janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkesat e palëve, të cilat marrin përgjigje të argumentuar, kjo e fundit jo gjithmonë bazohet në një vlerësim të pavarur të pretendimeve të ngritur bazuar në ligjin përkatës që gjen zbatim dhe faktet konkrete të çështjes, duke dalë direkt

⁷⁰ Vendimi nr. 591, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër

në konkluzionin për bazueshmërinë ose jo të kërimit përkatës në çështjet e marra në vlerësim. Ndërsa në disa vendime, gjyqtari nuk i ka marrë në analizë pretendimet e palëve, si në raport me bazueshmërinë e tyre në ligj ashtu edhe në raport me faktet e çështjes, megjithëse për ato gjyqtari ka disponuar përfundimisht.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, është “Mesatare”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
73	Shumë mirë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues nuk ka të dhëna.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit {...}, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet, pra datën e shortimit të secilës çështje dhe datën e vendimit. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit ose kërkesave pa palë kundërshtare, përveç parashikimeve të afatit ligjor të gjykimit për kërkesa të posaçme të tilla si kërkesa për sigurimin e padisë për të cilën neni 28, pika 3 i Ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 5 ditor të shqyrtimit apo çështje të tjera administrative të cilat, sipas ligjeve të posaçme, duhet të shqyrtohen brenda një afati të përcaktuar.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, nuk rezulton që për shqyrtimin e tyre, ligji të ketë parashikuar afat ligjor shqyrtimi.

Ndërkohë nga vëzhgimi i dosjeve që i përkasin vendimeve burim vlerësimi, rezulton se në dosjen nr.4, me nr.82 regjistri, datë 05.01.2016, përfunduar me vendimin nr.44, datë 25.01.2016, gjyqtari ka shqyrtuar kërkesën për pezullimin e veprimeve përmbartimore, e cila është shqyrtuar në seancën përgatitore të datës 11.01.2016, duke vendosur në përfundim të seancës refuzimin e kësaj kërkesë, duke e shqyrtuar për 6 ditë, jashtë afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 510, pg 2 të KPRC, duke e tejkalluar këtë afat me 1 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i pa përfillshëm, e për pasojë do të konsiderohet brenda afatit.

Gjithashtu, në dosjen 8 (3) që i përket çështjes administrative me nr. regjistri 298 datë regjistrimi 20.04.2015, me palë paditëse OST Tiranë, palë e paditur; Bashkia Sarandë, me objekt "*Pavlefshmëri absolute e aktit administrati; njoftim detyrimi tatimor. Sigurim padie etj.*", e përfunduar me vendimin nr. 257, datë 18.05.2015, gjyqtari ka shqyrtuar kërkesën për sigurimin e padisë, në seancën përgatitore datë 21.04.2015, duke vendosur pranimin e kërkesës, duke e shqyrtuar për 1 ditë, brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 202, pg 1 të KPRC .

Edhe në dosjen 11 (6), që i përket çështjes administrative me nr. regjistri 591, datë regjistrimi 06.10.2015, e përfunduar me vendimin nr. 591, datë 16.11.2015, gjyqtari ka marrë në shqyrtim në seancën përgatitore

të datës 12.10.2015, kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë në përfundim të së cilës ka vendosur pranimin e saj, duke e shqyrtuar këtë kërkesë për 6 ditë, duke e tejkualuar me 1 ditë afatin 5 ditorë të parashikuar në nenin 202, pg 1 të KPRC, tejkualim i cili vlerësohet i papërfillshëm e si i tillë do të konsiderohet e shqyrtuar brenda afatit.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, si dhe faktin se edhe çështjet e analizuara më sipër, vendimet gjyqësore nuk janë çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor për përfundimin e tyre, por duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër, rezulton se gjyqtari gjatë shqyrtimit të tyre ka marrë në shqyrtim tre kërkesa për të cilat ligji parashikon afat për shqyrtimin e tyre, dhe prej tyre dy kërkesa kanë përfunduar jashtë afatit 5 ditore duke e tejkualuar këtë afat me një ditë, tejkualim I cili vlerësohet i papërfillshëm,, rezulton se raporti i çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është 0 %.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi si dhe për shqyrtimin e kërkesave me afat ligjor, të paraqitura së bashku me padinë apo gjatë gjykimit, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor është 0 %.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se :” *Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë në intervalin kohor 1 muaj e 14 ditë (shih dosjen 1), 1 muaj (shih dosjen 2), 1 muaj e 12 ditë (shih dosjen 3), 20 ditë (shih dosjen 4) dhe 1 muaj e 5 ditë (shih dosjen 5). Në 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se afati standard i gjykimit prej 1 muaj është tejkaluar në 3 raste (shih dosjen 1, 3 dhe 5), megjithatë tejkalimi është disa ditor gjer në 14 ditë. Shkaqet për tejkalimin e afatit standard të gjykimit kanë qenë procedurale, e kombinuar me ngarkesën e lartë sasiore të gjyqtarit {...}. Në vlerësimin e kësaj të dhënë duhet mbajtur në konsideratë fakti se Sistemi i Vlerësimit, që ka caktuar standardin 1 muaj për kohëzgjatjen e gjykimeve administrative është miratuar nga KLD në vitin 2010 - përpara reformës së gjykatave administrative me ligjin nr. 49/2012, që ka ndryshuar në mënyrë thelbësore procedurat e gjykimit administrativ.*

Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti i rivlerësimit, ajo nuk mund të përcaktohet pasi në tekstin e këtyre vendimeve nuk shënohet koha e regjistrimit të çështjeve”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short.

Për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, gjykimi ka zgjatur vetëm për 1 çështje 1 muaj dhe për 4 çështje më pak se 1 muaj, ndërsa për 6 çështjet e tjera gjykimi ka tejkaluar standardin minimal kohor 1/muaj, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD. Kryesisht çështjet kanë përfunduar brenda afateve nga 1 muaj e 5 ditë minimalisht deri në 1 muaj e 20 ditë në një çështje.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit në gjykatën e shkallës së parë dhe as për shqyrtimin e tyre nga gjykata e apelit si shkallë e parë dhe as për çështje, shqyrtimi i të cilave kalon në seancë gjyqësore. Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, ai parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Ndërkohë, në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, nuk rezulton të jetë përcaktuar standardi minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e administrative të shkallës së parë, por afate gjykimi të shqyrtimit të këtyre mosmarrëveshjeve nga seksioni administrativ, që funksiononte në atë kohë. Lidhur me standardin minimal, në pikën 5, gërma c të Aneksit nr.1 të Vlerësimit parashikohet se; *”Gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 1 muaj”*.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, parashikon afate për kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Duke iu referuar parashikimeve të nenit 25, të ligjit nr.49/2012, në të cilin parashikohet afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake, afatit maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin, afatit maksimal 10 ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur, afatit maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm, afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, rezulton se veprimet përgatitore që duhet të kryejë gjyqtari në një çështje administrative me palë zgjatën mesatarisht 47 ditë.

Nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 25 të ligjit nr.49/2012, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat 15 ditë.

Pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, duhet të jetë brenda afatit ligjor 15 ditor. Në rast se procesi gjyqësor do të zhvillohet brenda një seance gjyqësore dhe nuk do të ketë kërkesa të palëve për shtyrje të gjykimit, kryerjen e veprimeve të tjera procedurale që do të pasjellin shtyrje të seancës, duke marrë parasysh vetëm afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.C për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 308 për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatja e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte minimalisht 25 ditë.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte brenda një afati minimal prej 87 ditësh. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, duke respektuar të gjitha hapat proceduralë të domosdoshëm për zhvillimit e gjykimit si dhe duke respektuar me rigorozitet afatet procedurale për kryerjen e tyre, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor orientues ende në fuqi.

Në këtë rast, respektimi strikt i afateve të parashikuara nga ligji nr.49/2012 dhe Kodit i Procedurës Civile, sjell një kohëzgjatje gjykimi të çështjeve më shumë se 1 muaj nga ajo e përcaktuar si standard orientues, e si i tillë ky i fundit nuk ka kuptim të gjejë zbatim.

Referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, konstatohet se:

- (i) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 683, datë 06.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Shfuqizimin urdhëri për largim nga puna dhe shpërblim dëmi”*, rezulton të jetë regjistruar në datë 22.09.2014, i është shortuar gjyqtarit në datë 23.09.2014 dhe ka përfunduar në datë 06.11.2014, brenda një afati prej 1 muaj e 14 ditë, apo për 46 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (ii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 730, datë 30.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Detyrimin për kthim në punë dhe shpërblim dëmi”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 30.10.2014, dhe ka përfunduar në datë 30.11.2014, brenda një afati prej 1 muaj apo 30 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (iii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 613, datë 24.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Kundërshtim akti administrativ”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 12.10.2015, dhe ka përfunduar në datë 24.11.2015, brenda një afati prej 1 muaj e 12 ditë apo për 42 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (iv) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 44, datë 25.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 05.01.2016 dhe ka përfunduar në datë 25.01.2016, brenda një afati prej 20 ditësh, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (v) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr.387, datë 10.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Kundërshtim akti administrativ”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 05.05.2014 dhe ka përfunduar në datë 10.06.2014, brenda një afati prej 1 muaj e 5 ditë, apo për 35 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (vi) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 549, datë 15.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Shfuqizim akti administrativ ...”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 07.07.2014, dhe ka përfunduar në datë 15.09.2014, brenda një afati prej 2 muaj e 8 ditë. Megjithatë po të zbresim nga ky afat, muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryejnë lejen vjetore, rezulton se çështja ka përfunduar për 1 muaj e 8 ditë apo 38 ditë, brenda **afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (vii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr.130, datë 17.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Shfuqizim akti”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 27.01.2014 dhe ka përfunduar në datë 17.03.2014, brenda një afati prej 1 muaj e 18, apo për 48 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (viii) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr. 257, datë 18.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Pavlefshmëri absolute e aktit administrativ”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 20.04.2015 dhe ka përfunduar në datë 18.05.2015, brenda një afati prej 28 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**
- (ix) Çështja administrative përfunduar me vendimin Nr. 284, datë 27.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt *“Detyrimin për pagim shumë që rrjedh nga kontrata...”*, rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar gjyqtarit në datë 04.05.2015

dhe ka përfunduar në datë 27.05.2015, brenda një afati prej 25 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**

(x) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr.158, datë 09.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt "*Anullim vendimi.....*", rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar gjyqtarit në datë 08.02.2015 dhe ka përfunduar në datë 09.03.2016, brenda një afati prej 29 muaj, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**

(xi) Çështja administrative përfunduar me vendimin nr.591, datë 16.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt "*Anullim Akti administrativ, akt konstatimit... Marrje mases së përkoshme, për pezullimin e veprimeve lidhur me mallin e konfiskuar*", rezulton të jetë regjistruar dhe shortuar në datë 06.10.2015 dhe ka përfunduar në datë 16.11.2015, brenda një afati prej 1 muaj e 10 ditë, apo 40 ditë, **brenda afatit minimal prej 87 ditësh.**

Referuar afatit 87/ditor të llogaritur më lart, si kohë e domosdoshme për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme, rezulton se nga 11 çështje të analizuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, sipas një llogaritje vetëm matematikore, të gjitha kanë përfunduar brenda këtij afati.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 11 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimale kohor, prej 78 të llogaritur si më lart. Pra në total: 100 % e çështjeve janë përfunduar brenda standardit minimal kohor, dhe 0 % jashtë standardit minimal kohor.

Sipas "*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit*", të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 0 % përkon me nivelin e vlerësimit 5 (pesë) pikë (0-10% - 5 pikë).

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej standardit minimal, është 0 %.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e analizimit të aftësive profesional të KLGJ-së nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga tre kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat administrative (*administrative me palë kundërshtare, marrëdhënie pune dhe administrative pa palë kundërshtare*). Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, në kushtet kur 3 vendimet e zgjedhura nga gjyqtari nuk kanë të dhënë për kohën e gjykimit të tyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje në raport me standardin minimal kohor 87 ditë, si afat minimal i nevojshëm për respektimin e afateve procedurale të domosdoshme, sipas kategorisë së çështjeve (*të gjitha çështjet janë çështje administrative me palë kundërshtare ose marrëdhënie pune*), rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje më i shkurtërt se standardi minimal kohor për secilën nga dy kategoritë të cilave i përkasin çështjet e analizuara.

Konkretisht :

(i) për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 8 çështjeve të kësaj kategorie⁷¹, rezulton të jetë 35 ditë, apo 1 muaj 5 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi për këtë kategori çështjesh.

(ii) për kategorinë e çështjeve “marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, duke iu referuar kohëzgjatjes së 3 çështjeve që i përkasin kësaj kategorie⁷², rezulton të jetë 33.7 ditë, apo 1 muaj e 3 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor në fuqi për këtë kategori çështjesh.

Për sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të dy kategoritë për të cilat ka të dhëna, me afatin 87 ditor të pranuar si një standard minimal për një gjykim administrativ, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më shkurtër se standardi për të dyja kategoritë e çështjeve, shkallë aftësie e cila sipas metodologjisë përkon me pikëzimin me 5 pikë..

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve

⁷¹ Dosja 3, dosja 4, dosja 5, dosja 7, dosja 8, dosja 9, dosja 10 dhe dosja 11.

⁷² Dosja 1, dosja 2 dhe dosja 3.

konkludohet se: “..Subjekti rivleresimit {...} ne periudhen e rivleresimit ka kryer detyrën e gjyqtarit dhe të kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokaster. Ai ka deklaruar se i janë caktuar 3821 çështje gjyqësore (63 çështje në vitin 2013, 1202 çështje në vitin 2014, 1271 çështje në vitin 2015 dhe 1285 çështje në vitin 2016) dhe se ka përfunduar 3663 çështje gjyqësore (34 çështje në vitin 2013, 1172 çështje në vitin 2014, 1238 çështje në vitin 2015 dhe 1219 çështje në vitin 2016), duke mbartur 33 çështje gjyqësore në vitin e fundit. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 95.8 %.”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit të përbërë nga 3 vite kalendarike, dy prej të cilëve janë jo të plotë, rezulton se :

Në total në gjithë periudhën e vlerësimit, nga dita që gjyqtari ka filluar punë efektivisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Gjirokastër (04.11.2013) deri në datë 08.10.2016. Sipas të dhënave statistikore mbi bazën e të cilave është organizuar edhe shorti, të administruara në dosjen e rivlerësimit,⁷³ rezulton se gjyqtari {...} për gjithë periudhën e vlerësimit 08.10.2013 (04.11.2013)–08.10.2016, ka përfunduar së gjykuari 4030 çështje gjithësej, nga të cilat 714 çështje administrative, 312 marrëdhënie pune, 74 çështje të tjera dhe 2930 urdhëra ekzekutimi, e ndarë për çdo vit kalendarik:

- Për vitin 2013 (04.11.2013-31.12.2013), gjyqtari ka përfunduar gjykimin në total për 34 çështje, nga të cilat 17 çështje administrative, 10 marrëdhënie pune, 2 të veçanat (kërkesa) dhe 5 urdhëra ekzekutimi.
- Për vitin 2014 (01.01.2014-31.12.2014), gjyqtari ka përfunduar gjykimin për 1526 çështje, nga të cilat 195 çështje administrative, 188 marrëdhënie pune, 25 çështje të veçanta/ kërkesa dhe 1118 urdhëra ekzekutimi;
- Për vitin 2015 (01.01.2015- 31.12.2015), gjyqtari ka përfunduar gjykimin për 1263 çështje, nga të cilat 266 çështje administrative, 61 marrëdhënie pune, 19 çështje të veçanta/ kërkesa dhe 917 urdhëra ekzekutimi.
- Për vitin 2016 (01.01.2016-08.10.2016) gjyqtari ka përfunduar gjykimin për 1207 çështje, nga të cilat 236 çështje administrative, 53 marrëdhënie pune, 28 çështje të veçanta/ kërkesa dhe 890 urdhëra ekzekutimi.

Por sipas vërtetimit nr.945 prot., datë 24.10.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit, 04.11.2013- 2016, gjyqtarit i janë shortuar gjithësej 3821 çështje dhe ka përfunduar 3663 çështje, në bazë të cilës më pas gjyqtari ka bërë dhe vetvlerësimin e tij. Pra kostatohet se numri i çështjeve të përfunduara gjatë kësaj periudhe, sipas

⁷³ Faqe 107- 278 të dosjes së rivlerësimit.

të dhënave statistikore të përcjella në vitin 2017 dhe vërtetimit të lëshuar në datë 24.10.2016 është i ndryshëm, me një diferencë prej 367 çështje.

Duke qenë se nuk ka të dhëna të tjera të administruara në dosjen e rivlerësimit në lidhje me numrin e çështjeve të caktuara, do të marrim të mirëqenë rendimentin e llogaritur në Raportin analitik, të rivlerësimit, e cila ka rezultuar në masën e 95.8 %, i cili është nxjerë bazuar në deklarin e vetë gjyqtarit. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, kjo përqindje pikëzohen me 8 pikë (mbi 93-99 %/8 pikë).

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “c” të vendimit të KLD, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë i seksionit administrativ, si relator gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak se 150 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.

Ndërsa në pikën 3, shkronja “k” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se; *“Kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese minimale respektivisht në masën e 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate”.*

Rezultoi se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka ushtruar detyrën e kryetarit të gjykatës, çka nënkupton një ngarkesë në punë jo më pak se 60 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarit {...} ({...}), të standardit sasior në fuqi, rezulton si më poshtë vijon :

Në lidhje me periudhën që ai ka punuar si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër (04.11.2013 -08.10.2016), nga të dhënat statistikore të gjykatës rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 4030 çështje gjithësej, nga të cilat 1026 çështje me palë kundërshtare (714 çështje administrative dhe 312 marrëdhënie pune) dhe 74 çështje të tjera dhe 2930 urdhëra ekzekutimi, pra mesatarisht 342 çështje themeli në vit.

Pra përgjatë kësaj periudhe ai ka gjykuar mesatarisht rreth 342 çështje themeli në vit, ndërkohë që duhej të shqyrtonte jo më pak se 150 çështje themeli në vit, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së, pika “c”⁷⁴, nëse do të kishte kryer vetëm detyrën e gjyqtarit dhe jo më pas se 60 çështje themeli në kushtet kur ai ushtruar edhe detyrën e kryetarit të gjykatës, duke qenë mbi standardin minimal të shqyrtimit të çështjeve në masën mbi 128 %, ngarkesë në punë si gjyqtarë, dhe mbi 400 % në kushtet kur ai ka kryer edhe detyrën e kryetarit të gjykatës, rrethanë kjo që justifikon pikëzimin maksimal të gjyqtarit.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit është 95.8 % i përcaktuar në Raportin KLGJ-së, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 8 pikë, pasur parasysh faktin se në çdo vit ai e ka tejkuluar standartin minimal të ngarkesës në punë, mesatarisht me rreth mbi 128 % në vit duke iu referuar vetëm punës së gjyqtarit dhe me mbi 400 % duke marrë parasysh faktin se ai ka ushtruar edhe detyrën e kryetarit të gjykatës, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet maksimalisht, me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 10 pikë, duke qenë se në çdo vit ai e ka tejkuluar standartin minimal sasior, mbi 50 %, konkretisht me 128 % si gjyqtarë i gjykatës administrative.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar.

⁷⁴ Pika 3, germa (c) e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, parashikon se: “Standardi sasior I punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkesë pune minimale si më poshtë; c. Gjyqtari i shkallës së parë I dhomës civile, si relator, I seksionit administrative, jo më pak se 150 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.”

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *”Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...} i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohe të vendimeve gjyqësore, pavarësisht ngarkesës së lartë sasiore që ai ka patur. Në 4 raste, vendimi është arsyetuar brenda afatit ligjor 7 ditor (shih dosjet 2, 3, 4 dhe 5) dhe vetem në 1 rast tej këtij afati (shih dosjen 1). Konkretisht, vendimet janë arsyetuar prej tij pas 1 muaji e 24 diteve (shih dosjen 1), pas 4 ditëve (shih dosjet 2 dhe 4), pas 3 ditëve (shih dosjen 3) dhe pas 5 ditëve (shih dosjen 5). Është e paqartë përse në rastin e dosjes 1, ka patur vonesë prej më shume se 1 muaji në arsyetimin e vendimit gjyqësor.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim si dhe për 1 çështje, për shkak të ankesës, e cila i është evidentuar gjyqtarit për efekt vlerësimi nga Inspektoriati i KLD.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i) Dosja që i përket vendimit nr. 683, datë 06.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, është dorëzuar më datë 30.12.2014, 1 muaj e 24 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (ii) Dosja që i përket vendimit nr. 730, datë 30.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, është dorëzuar më datë 05.12.2014, 4 ditë nga shpallja e vendimit,

- brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- (iii) Dosja që i përket vendimit me nr. 613, datë 24.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 27.11.2015, 3 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - (iv) Dosja që i përket vendimit me nr. 44, datë 25.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 29.01.2016, 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - (v) Dosja që i përket vendimit me nr.387, datë 10.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 15.06.2014, 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - (vi) Dosja që i përket vendimit me nr nr. 549, datë 15.09.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 20.09.2014, 5 (pesë) ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - (vii) Dosja që i përket vendimit me nr.130, datë 17.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 28.03.2014, 11 (njëmbëdhjetë) ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke e tejkaluar këtë afat me 4 ditë;
 - (viii) Dosja që i përket vendimit me nr. 257, datë 18.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 22.05.2015, 4 (katër) ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - (ix) Dosja që i përket vendimit me Nr. 284, datë 27.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 29.05.2015, 2 (dy) ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - (x) Dosja që i përket vendimit me nr.158, datë 09.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 15.03.2016, 6 (gjashtë) ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
 - (xi) Dosja që i përket vendimit me nr.591, datë 16.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është dorëzuar më datë 20.11.2015, 4 (katër) ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7 ditor përcaktuar në nenin 42/3 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Referuar të dhënave si më sipër, për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, koha mesatare e arsyetimit të vendimit rezulton të jetë 9.24 ditë, pra më e gjatë se afati i parashikuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012, duke e tejkaluar këtë afat 2 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm e për pasojë do të konsiderohen se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është sa afati ligjor prej 7 ditësh.

Duke iu referuar dy kategorive të çështjeve, rezulton se:

- (i) për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është **5.2 ditë**, brenda afatin 7 ditorë.
- (ii) për kategorinë “marrëdhënie pune”⁷⁵, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është **21 ditë**, duke e tejkalluar afatin 7 ditorë, me 14 ditë, ku në tejkalimin e këtij afati ka ndikuar vetëm një dosje, pasi po të zbresim këtë dosje, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e shkurtër se afati procedural.

Sa më sipër, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, rezulton “*Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve*” dhe sipas metodologjisë pikëzohet me 9 pikë.

KONKLUZIONE

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë tre vjeçare, konkretisht deri në datë 08.10.2016, gjyqtari ka dhënë 4030 vendime, nga të cilat 1026 çështje me palë kundërshtare (714 çështje administrative dhe 312 marrëdhënie pune) dhe 74 çështje të tjera dhe 2930 urdhëra ekzekutimi, pra mesatarisht 342 çështje themeli në vit apo mesatarisht 1343 vendime në vit, pra rreth 122 vendime në muaj, dhe mesatarisht 5.5 vendime në ditë, referuar ditëve mesatare të punës në një muaj prej 22 ditësh, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, faktin se koha mesatare e arsyetimit të 10 vendimeve burim vlerësimi nga 11 të tilla është kaluar vetëm për një çështje, që ka sjellë më pas edhe tejkalimin e këtij kohës mesatare për një nga kategoritë e çështjes,, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, propozohet që për këtë tregues gjyqtari të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, duke arritur në pikëzimin maksimal, me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.** Referuar sa më sipër, për këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.*

⁷⁵ Dosja 1, dosja 2 dhe dosja 6.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se; “ Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 2 seanca gjyqësore (shih dosjen 1, 2, 4 dhe 5) dhe me 4 seanca (shih dosjen 3). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 12 seanca gjyqësore, nga të cilat 10 seanca kanë qenë produktive. Janë konstatuar vetëm 2 seanca gjyqësore joproduktive, ku pengesë është bërë mosparaqitja e autorizimit për përfaqësuesin prej të paditurit (shih dosjen 2) dhe mosparaqitja e ekspertit (shih dosjen 3)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare (çështje administrative me palë kundërshtare dhe marrëdhënie punë) , lidhur me numrin e seancave gjyqësore, rezulton si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:

(i) **Dosja 1**, çështja me nr. 678 regjistri, datë regjistrimi 22.09.2014, përfunduar me vendimin nr. 683, datë 06.11.2014. Për përfundim e saj janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore** të dokumentuar nëpërmjet procesverbalit me shkrim (jashtë regjistrimit audio) Nuk ka seanca jo produktive.

(ii) **Dosja 2**, çështja me nr. 753 regjistri, datë regjistrimi 30.10.2014, përfunduar me vendimin nr. 730, datë 01.12.2014. Për përfundim e saj janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, nga të cilat një ka qenë jo produktive, e shtyrë për shkak se përfaqësuesi i palës së paditur nuk ka pasur aktin e përfaqësimit.

(iii) **Dosja 3**, çështja me nr. 612 regjistri, datë regjistrimi 12.10.2015, përfunduar me vendimin nr. 613, datë 24.11.2015. Për përfundim e saj janë zhvilluar **4 seancë gjyqësore**, nga të cilat një ka qenë jo produktive, e shtyrë për shkak të mosparaqitjes së ekspertit.

(iv) **Dosja 4**, çështja me nr me nr. 82 regjistri, datë regjistrimi 05.01.2016, përfunduar me vendimin nr. 44, datë 25.01.2016. Për përfundim e saj janë zhvilluar **2 seancë gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

(v) **Dosja 5**, çështja me nr. 386 regjistri, datë regjistrimi 05.05.2014, përfunduar me vendimin nr.387, datë 10.06.2014. Për përfundim e saj është zhvilluar **2 seancë gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Në çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit:

(vi) **Dosja 6**, çështja me nr. regjistri 539, datë regjistrimi 07.07.2014, përfunduar me vendimin nr. 549, datë 15.09.2014. Për përfundim e saj janë zhvilluar **2 seancë gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

(vii) **Dosja 7**, çështja me nr. regjistri 78, datë regjistrimi 27.01.2014, përfunduar me vendimin nr.130, datë 17.03.2014. Për përfundim e saj janë planifikuar 3 seanca gjyqësore, nga të cilat një nuk është zhvilluar për shkak të mosparaqitjes së gjyqtarit për arsye të përligjura;

(viii) **Dosja 8**, çështja me nr. regjistri 298 datë regjistrimi 20.04.2015, përfunduar me nr. 257, datë 18.05.2015. Për përfundim e saj janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

(ix) **Dosja 9**, çështja me nr. regjistri 344, datë regjistrimi 04.05.2015, përfunduar me vendimin nr Nr. 284, datë 27.05.2015. Për përfundimin e saj është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, në përfundim të cilës gjyqtari ka shpallur vendimin.

(x) **Dosja 10**, çështja me nr. regjistri 162, datë regjistrimi 08.02.2016, përfunduar me vendimin nr. 158, datë 09.05.2016. Për përfundimin e saj janë zhvilluar 3 seanca, nga të cilat 1 nuk ka qenë produktive, e shtyrë për shkak të mungesës së aktit të përfaqësimit të palës së paditur.

(xi) **Dosja 11**, çështja me nr. regjistri 591, datë regjistrimi 06.10.2015, përfunduar me vendimin nr.591, datë 16.11.2015. Për përfundimin e saj janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në çështjet e vëzhguara varion nga 1 deri në 4 seanca. Numri i përgjithshëm i seancave të planifikuar për 11 dosjet e vëzhguara është 26 seanca gjyqësore.

Sa i përket numrit të seancave gjyqësore rezulton se: (i) për çështje të kategorisë *administrative me palë kundërshtarë*” numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.6 seanca gjyqësore; (ii) për çështje të kategorisë *“marrëdhënie pune”* numri mesatar është 1.6 seanca gjyqësore .

Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 11 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 2.36 seanca.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short rezulton se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët.

Në çështjen në të cilat seanca gjyqësore nuk është çelur për shkak të mos formimit të trupit gjykues apo angazhimit të gjyqtarit si pjesmarrëse në trajtim në Shkollën e Magjistraturës (vetëm një rast), rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt, përveç periudhës së muajit gusht, gjatë secilit gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen vjetore. Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, njoftimin e palës së paditur për të cilën nuk konfirmohet dijenia, marrjes së provës me dëshmitar, dhënien e kohës palës së paditur për tu paisur me akt përfaqësimi, thirrjen e ekspertit, dhënien e kohës ekspertit për të kryer aktin e ekspertimit. dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar në referim të parashikimeve të nenit 302 të K.Pr.C Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, kur ligji parashikon të tilla (*afati 5 ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar*).

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short, dhe 1 çështje të referuar për shkak të ankesave rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 2.36 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive dhe planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore është 32.366 seanca për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është shumë e lartë, gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë, pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 2.361 seanca dhe në çdo rast gjyqtari ka kryer veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ lidhur me këtë tregues, konkludohet se;” *“Subjekti i rivlerësimit {...} i ka vënë në lëvizje dosjet e vëzhguara përmes vendimeve formale. Në një rast, është konstatuar se veprimi përgatitor i çështjes është dokumentuar të jetë kryer 1 ditë përpara organizimit të shortit dhe është e paqartë nëse bëhet fjalë për gabim material në dokumentimin e veprimt (shih dosjen 1). Ai zhvillon rregullisht veprimet përgatitore sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012. Në vijim, cakton dhe zhvillon seancat gjyqësore, të cilat përgjithësisht janë produktive.*

Veprimet përgatitore të gjyqtarit kanë disa pasaktësi formale, nuk bëhet diferenca midis veprimt përgatitor dhe seancës përgatitore; aktet formulohen standard dhe nuk i përgjigjen specifikave të rastit. Në një çështje është konstatuar se eksperti është caktuar gjatë gjykimit dhe nuk është e qartë, përse ai nuk është caktuar gjatë veprimeve përgatitore (shih dosjen 3)”. Në një rast tjetër është konstatuar se gjatë veprimeve përgatitore nuk është identifikuar se provat e paraqitura nga gjykata që kishte përcjell çështjen për kompetence lëndore ishin fotokopje (shih dosjen 5). Gjatë gjykimit, ai kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e çështjes dhe në përfundim të gjykimit, ka disponuar gjithnjë me vendim përfundimtar. Kur seanca gjyqësore është shtyre, shkak i shtyrjes ka qenë procedural dhe seanca vijuese është caktuar shpejt dhe pa vonesa, duke mbajtur në konsideratë shkakun e shtyrjes së saj. Ai ka mbikeqyrur aktet e njoftimit, të cilat janë dërguar pa asnjë vonese. Nuk ka pasur asnjë seance të deshtuar për shkak të njoftimeve.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtarë (8 çështje administrative me palë kundërshtarë dhe 3 çështje

gjqësore marrëdhënie pune) , lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton si më poshtë:

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke zhvilluar veprimet përgatitore në dhomë këshillimi brenda një kohë shumë të shkurtër nga caktimi i tyre me short, në çdo rast brenda afatit ligjor 7 ditor nga data e shortit në përputhje me parashikimet e nenit 25 pika 1 të ligjit nr.48/2012. Në 11 dosjet e vëzhguara rezulton se seanca e parë për kryerjen e veprimeve përgatitore është zhvilluar ditën e shortit ose një ditë pas shortit.

Në veprimet përgatitore të zhvilluara pas caktimit të çështjeve me short, gjyqtari përgjithësisht kryen me korrektësi dhe në mënyrë të plotë veprimet procedurale të parashikuara në nenin 25 pika 1 të Ligjit nr.49/2012 duke evidentuar të metat e padisë, njoftimin e palës paditëse për plotësimin e tyre brenda afatit ligjor, disponon për njoftimin e padisë dhe akteve palës së paditur, bashkë me njoftimin për paraqitjen e tyre brenda afati ligjor 10 ditor duke shoqëruar disponimin e gjykatës dhe njoftimin e palës me paralajmërimin për mospranimin e tyre në rast të mosparaqitjes në afat, në respektim të parashikimeve të nenit 25 pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 49/2012. Por konstatohet se jo gjithmonë gjyqtari kryen veprimet e nevojshme procedurale. Konkretisht nga 11 dosjet burim vlerësimi dhe 3 vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, rezulton se gjyqtari vetëm në një rast ka njoftuar Avokaturës së Shtetit si dhe i ka njoftuar aktet, megjithëse konstatohet se në këto gjykimi ka qenë e nevojshme pjesmarrja e tij, përse kohë që njëra nga palët është organ publik, çështjet kanë interes publik. Gjithashtu, konstatohet se në disa dosje, gjyqtari shprehet se duhet të njoftohet eksperti apo dëshmitari, por duket se kjo është formale, aq më tepër kur nga 11 dosjet e përzgjedhura me short vetëm në një prej tyre është caktuar ekspert, por edhe në këtë rast eksperti është caktuar në seancën e parë gjyqësore, dhe jo në veprimet përgatitore siç parashikon neni 25 i ligjit nr.49/2012, i ndryshuar⁷⁶.

⁷⁶ Neni 25 I ligjit nr.49/2012, parashikon se:” *Për zhvillimin e gjykimit, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime:*

a) I kërkon paditësit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditësi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkëlidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë.

b) I njofton të paditurin padinë dhe aktet shoqëruese të saj, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi, për depozitimin në sekretari të prapësimeve me shkrim, të listës së personave, që i padituri kërkon të thirren në gjykim, me cilësinë e dëshmitarit apo të ekspertit dhe adresat e tyre, si dhe të akteve të plota shkresore, në të cilat janë bazuar kryerja e veprimit administrativ dhe shqyrtimi i ankimit administrativ. Në rastin e padisë me të meta, gjyqtari e dërgon këtë njoftim për të paditurin, në datën e plotësimit të të metave nga paditësi.

c) Merr vendim për kryerjen e ekspertimit kur çmon se për zgjidhjen e çështjes ka nevojë për njohuri të posaçme. Në këtë vendim ai përcakton fushën e ekspertimit, ekspertin nga lista e gjykatës, detyrat përkatëse, si dhe afatin e kryerjes së ekspertimit, i cili, si rregull, nuk mund të jetë më i gjatë se 20 ditë”

Pas kalimit të afatit për paraqitjen nga pala e paditur të prapësimeve me shkrim të provave, gjyqtari thau se gjithmonë ka disponuar me vendim për kalimin e çështjes direkt në seancë gjyqësore, dhe për këtë veprim ka mbajtur procesverbal, ku gjyqtari ka konkluduar se janë kryer të gjitha veprimet procedurale dhe se vlerësohet se çështja duhet të kalohet në seancë gjyqësore. Por në këto procesverbale nuk janë evidentuar veprimet konkrete të kryera nga gjyqtari gjatë veprimeve përgatitore. Vetëm në rastet kur si objekt është paraqitur edhe kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë, gjyqtari ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore ku ka marrë në shqyrtim vetëm këtë kërkesë, përpara kryerjes së veprimeve përgatitore, që kanë të bëjnë me njoftimin e kërkesës padisë dhe akteve palës së paditur. Pra përgjithësisht konstatohet se nga gjyqtari nuk është vlerësuar në asnjë rast nevoja për zhvillimin e seancës përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, përveç seancë që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr.49/2012 gjyqtari ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila në përgjithësisht, në dosjet e vëzhguara është caktuar brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012, përveç rastit kur kjo periudhë përkon me muajin gusht gjatë secilës gjyqtarët kryerjen lejen vjetore dhe në një rast në muajin dhjetor, që përkon me festat e fundvitit dhe mbartjen e dosjeve në fillim të muajit janar të çdo viti. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, është arsyetuar më vete dhe është pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 3 të ligjit nr.39/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur në mënyrë manuale, por asnjë me regjistrim audio, pasi ky sistem është vënë në funksionim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjyroskopit, në datë 03.10.2016. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.C dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur; disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; lejimin e shqyrtimit të provave, administrimin e tyre, duke i listuar; drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat; dhënien fjalën palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; disponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë përgjithësisht të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (në rastet e disponimit për kërkesat e palëve lidhur me ndërgjyqësinë, saktësimin e objektit të padisë, shtyrjen e seancës).

Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, në ato raste kur është evidentuar ora e fillimit të seancës, pasi disa seanca nuk e kanë të pasqyruar orarin e fillimit dhe të mbarimit të seancës.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesatare në këtë tregues, evidentuar në shpejtesinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor. Por nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve procedurale sipas rregullave procedurale të parashikuara në ligjin nr.49/2012 si dhe në Kodin e Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive, caktimin e ekspertit, njoftimin e kërkesë padisë dhe akteve avokaturës së shtetit sipas nenit 79/a të K.Pr.Civile, planifikimit dhe zhvillimi i seancave përgatitore kur është e nevojshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 16 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit ;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga Inspektorati i KLD, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht është konstatuar se gjyqtari ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtari ka nxjerre vendim formal për caktimin e seances përgatitore apo gjyqësore. Nuk ka patur asnjë rast kur seanca nuk është celur pasi mungon gjyqtari. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesepadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet perfundimtare, fletethinjet, provat etj. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikepamja formale. Lidhur me procesverbalin gjyqësor është konstatuar se shënohet saktësisht ora e fillimit, por e perfundimit jo në të gjitha seancat. Në rastet kur janë konstatuar gabime materiale, ato lidhen me shpejtesinë e hartimit të tyre dhe nuk kanë sjelle pasoja. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit, me përjashtim të një rasti (shih dosjen 5). Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar rregullisht aktet proceduriale.”*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes konstatohet se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjet ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes fillon me aktin e regjistrimit të çështjes në gjykatë, procesverbalin e shortit, padinë dhe provat e paraqitura nga pala paditëse, prapësimet dhe provat e paraqitura nga pala e paditur (kur prapësimet janë paraqitur me shkrim), kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, aktet e njoftimit, procesverbalet e seancave të veprimeve paraprake, seancave përgatitore dhe gjyqësore, vendimi gjyqësor përfundimtar (dorëshkrim dhe vendimi i numërtuar) vendimi për pranimin e ankimit në rastet kur palët kanë paraqitur ankim, aktet e njoftimit të vendimit dhe procesverbali audio në rastet kur seancat janë regjistruar në sistem audio. Brenda kategorisë aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta nën aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ lidhur me këtë tregues, konkludohet sikurse është përshkruar në treguesin 2.C.A, më sipër “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e paraqitura nga palët (padija, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet e palëve kur ato janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, vendimet e gjykatës për kryerjen e veprimeve përgatitore, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, procesverbalet e çdo seancë të zhvilluar në dhomë këshillimi, seancë përgatitore dhe gjyqësore, vendimet gjyqësore, vendimet për pranimin e ankimit të palëve ndërgjyqëse, procesverbali audio kur seancat janë zhvilluar me sistem audio).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
96	Shkëlqyeshëm

1. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se *“..Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...} ({...}), për periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional. Për gjyqtaren {...}, është depozituar një ankesë në ish-Inspektoriatin e KLD-së e cila me krijimin e ILD-së, i ka kaluar për trajtim këtij të fundit dhe ndodhet në proces verifikimi. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.”*.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton se gjatë periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 9 ankesa (5 të vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 3 të vitit 2016) në Inspektoriatin e ish KLD-së.

Katër ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se 2 prej tyre (2 të vitit 2014) janë ankesa të përsëritura, 2 prej tyre (të vitit 2016) zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta.

Pesë ankesat e tjera janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 3 ankesa të vitit 2014 verifikuar për zvarritje gjykimi, i janë regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje
- 1 ankesë⁷⁷ sugjeruar verifikim për shkelje etike, i është dërguar ILD-së , e cila pas verifikimit të saj ka vendosur arkivimin.

KLGJ, me shkresën nr. 2388 prot, datë 13.04.2023 i ka kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vënien në dispozicion të rezultateve të trajtimit të ankesës nr. 647 prot, datë 08.02.2016 që i

⁷⁷ Ankesë nr. 647 prot, datë 08.02.2016 që i përket ankuesit B.I

përket ankuesit B.I dhe trajtimin me përparësi të saj në rast se ankesa nuk është trajtuar. Kjo kërkesë i është ripërsëritur ILD-së me shkresën nr.2388/1, datë 25.04.2023.

Në përgjigje të kërkesës së drejtuar, ILD me shkresën me nr.1186/1 prot., datë 26.04.2023, ka informuar se për këtë ankesë, pas verifikimit përkatës është vendosur arkivimi. Gjithashtu, është administruar edhe vendimi me nr.2256/1 prot., datë 11.11.2022 “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasit Z. B.P”, ku nga përmbajtja e tij, rezulton se janë bërë verifikimet përkatëse megjithëse ankesa është arkivuar për shkak të kalimit të afatit 5 vjeçar nga momenti i ndodhjes së shkeljes së pretenduar, nga të cilat nuk rezulton asnjë e dhënë e provuar që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbajtje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit. Gjithashtu nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...}, nga të dhënat e rezultuara nga dosja personale dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në ish-Inspektoriatin e KLD-së, gjatë periudhës së rivlerësimit profesional 08.10.2013-08.10.2016, nuk rezultoi të jenë regjistruar ankesa, ku të vihet në dyshim integriteti i gjyqtarit {...} {...}.”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e Inspektoratit të KLD;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Vendimi nr. 576, datë 20.10.2022 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave gjatë periudhës së vlerësimit (analizuar në treguesin më sipër), nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 576, datë 20.10.2022, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë për gjyqtarin {...} konkludohet se: *“Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë, si dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Trupi gjykues vlerëson se diferenca e konstatuar në analizën financiare të vitit 2016 nuk janë në masën që cenojnë besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë mase nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e saj, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ajo nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në vijimësi. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.”⁷⁸*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLUZIONI

⁷⁸Vendimi nr. 576, datë 20.10.2022 i KPK, faqe 20.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integriteti si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarit për treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga gjyqtari.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së nuk ka të dhëna për këtë tregues.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, konkludohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të jetë i pa konsiderueshëm.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “i pakonsiderueshëm” dhe gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

Nivelin i vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit Pikët
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ-së;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e hartuar nga KLGJ konkludohet se; *Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...}({...}) komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, respekton solemnitetin e gjykimit, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe duke respektuar barazinë e palëve. Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre dhe në çdo rast duke respektuar normat e komunikimit zyrtar dhe etik.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave përgatitore dhe gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të.

Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në përpilimin e akteve procedurale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cënim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e KLGJ-së konkludohet se: “..Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarit {...} {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta....”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, vlerësohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga tre burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën të bashkëpunimit, passjell si pasojë prezumimin se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivelin të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e KLGJ;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ, rezulton se *“Gjatë periudhës së rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 16 trajnime të Shkollës së Magjistratures, 22 ditë të formimit vazhdues (shih Trajnimet ne 3 Vitet e Fundit). Lënda e trajnimeve, ku ai ka marre pjese, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ të shkalles se pare. Gjate periudhes së rivlerësimit nuk dokumentohet që gjyqtari {...} të jetë angazhuar në aktivitete te tjera profesionale, jashte Shkolles se Magjistatures.*

Referuar vërtetimit me nr. 557 prot, datë 20.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues në 16 aktivitete trajnuese të zhvilluara në 21 ditë, kryesisht në fushën e së drejtës administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht të për tema që i përkasin së drejtës administrative dhe gjykimit administrativ, gjithsej 16 aktivitete të zhvilluara për 21 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtari lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016 nuk është angazhuar në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç janë; fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësohet se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë duhet të pikëzohet me 0 pikë për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër për treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	73	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	360	Shumë mirë

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE

NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}

PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013 – 2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE

Treguesit		Burimet	Niveli
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short); 	Mbi mesataren
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në të çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short); 	Mesatare
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short); 	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short); 	Mbi mesataren

	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të rra me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e rra me short); 	Mesatare

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE

Tregues	Burimet	Niveli	
A. Aftësia për të përballuar në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të rra me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e rra me short); 	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të rra me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e rra me short); 	0-10 %
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të rra me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e rra me short); 	Më e shkurtër bartë me për të gjitha e çështjeve.

	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve	▪ Dosja e rivlerësimit;	Mbi 99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short);	Më e shkurtër bartë me afatin për të gjitha e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për dhe kryerja e veprimeve të nevojshme për shmangien e atyre jo-produktive	b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short);	1-3 seanca kallë shumë e sisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme për organizimin e procesit gjyqësor	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short);	Mbi mesataren

C. Aftësia e gjyqtarit për të par dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short); 	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e cionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short); 	Shumë e lartë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Niveli
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, injiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të para me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e para me short); 	Shumë e lartë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	▪ Dosja e rivlerësimit;	I pa eshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Niveli
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të rra me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e rra me short);	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe të dhënave personale	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të rra me short pas fillimit të së vlerësimit (6 dosjet e rra me short);	I lartë
B. Aftësia për të nuar	a. Shkalla e komunikimit dhe mit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe mit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë

C. Gatishmëria e gjyqtarit gazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit;	15-120 ditë
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të kandiduar për gjyqtarë gjatë stazhit profesional trajnimin e gjyqtarëve	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari funksionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimi ligjore akademike	• Dosja e rivlerësimit;	Nuk ka të dhëna
NIVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			S
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR